



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije



Nr. Prot. 065/B/11

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT DHE PARIMET

E INSPEKTIMIT TË ZHVILLUARA NGA

AUTORITETI RREGULLATOR I TELEKOMUNIKACIONIT

KAPITULLI I

Qëllimi dhe Shtrirja, Baza ligjore, Përkufizimet dhe Parimet

Qëllimi dhe Shtrirja
Neni 1

- (1) Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që në vazhdim të përcaktoj procedurat dhe parimet të përmbledhura me dispozitat e mëposhtme të Ligjit mbi Telekomunikacionin, në lidhje me aktivitetet e inspektimit të zhvilluara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit.
- (2) Kjo rregullore përmban detyrat dhe përgjegjësitë e njësive relevante, dhe të inspektorit si dhe gjithashtu edhe obligimet e palëve që janë subjekt i inspektimit.

Baza Ligjore
Neni 2

- (1) Kjo rregullore është përgatitur në bazë të dispozitave të Seksionit 2, (nenit 2) neni 4 paragrafi (4), neni 6 paragrafi (1) dhe (8), neni 14 paragrafët prej (1) deri në (4) dhe neni 15 paragrafët prej (1) deri në (5) të Ligjit mbi Telekomunikacionin (Nr. 2002/ 07), datë 3 Maj 2003 (i ndryshuar me Ligjin (Nr. 03/L/-085) i datës 13 Qershor 2008 dhe dispozitave të neneve; 6, 26, dhe 27 të Ligjit mbi Shërbimet Postare, datë 15 Prill 2010 dhe numër 03/L-173 (Më tej referuar si Ligj).

Përkufizimet Neni 3

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore do të kenë domethëniet e mëposhtme;

- a) **Inspektor;** Personi/personat e caktuar për inspektim (kontroll), personat fizik ose subjektet ligjore të cilët janë subjekt i inspektimit të Autoritetit në pajtim me dispozitat e legjislacionit relevant.
- b) **Inspektimi;** Tërësia e aktiviteteve përbërë nga; ekzaminimet, kontrollet paraprake dhe/ose proceset e hetimit me qëllim të përcaktimit të pajtueshmërisë së aktiviteteve dhe praktikave të palës së inspektuar (kontrolluar) me dispozitat e legjislacionit relevant,
- c) **Njësia Koordinuese e Inspektimit;** Një prej komisioneve të përhershme funksionale të Autoritetit e themeluar me vendim të Bordit, e përbërë nga udhëheqësit e njësive relevante dhe sektorët e Autoritetit, dhe e kryesuar/mbikëqyrur nga një prej Anëtarëve të Bordit të Autoritetit i caktuar nga Bordi, me qëllim të kryerjes së koordinimit të aktiviteteve (planit të inspektimit) në lidhje me aktivitetet e inspektimit të autoritetit,
- d) **Pala subjekt i inspektimit;** Persona fizik apo persona juridik, të cilët janë subjekt i inspektimit të Autoritetit.
- e) **Njësia relevante;** Njësitë kryesore të shërbimit; departamentet dhe sektorët e Autoritetit, të cilët janë drejtpërdrejtë të lidhur me inspektimin; (Sektori i Radio-monitorimit, Departamenti i Telekomunikacionit dhe Sektori i Shërbimeve Postare).
- f) **Bordi;** Autoriteti ligjor i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit.
- g) **Kryetari i Bordit;** Kryetar i Bordit.
- h) **Autoriteti;** Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit.
- i) **Propozimi;** Procesi përgatitor duke formuar bazën në mënyrë që Bordi të sjellë vendime.

Parimet e Inspektimit Neni 4

- (1) Parimet e mëposhtme do të merren parasysh në mënyrë që të zbatohet një inspektim efektiv.
 - a) Trajtimi drejtë dhe jo diskriminues i të gjitha subjekteve gjatë aktiviteteve të inspektimit.
 - b) Sigurimi i konfidencialitetit të informatës dhe dokumenteve të siguruar gjatë aktiviteteve të inspektimit, për të shmangur/evituar zbulimin e një informate të tillë dhe dokumenteve përveç organeve të autorizuara me Ligj.
 - c) Paanshmëria gjatë rrjedhës së inspektimit, vlerësimit të rezultateve dhe hartimit të raportit të inspektimit.

- d) Parandalimi i ndonjë ndërhyrjeje qoftë nga brenda apo jashtë Autoritetit, që mund të ndikoj në ndershmëri apo paanshmëri.
- e) Trajtimi me kujdes dhe vëmendje në secilën fazë të aktivitetit të inspektimit.
- f) Pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të inspektimit përveç atyre të rregulluara përmes kësaj rregulloreje.

KAPITULLI II **Të Drejtat dhe Obligimet**

Obligimet e palës subjekt i inspektimit **Neni 5**

- (1) Pala subjekt i inspektimit është e obliguar;
 - a) Të ofroj ambient të përshtatshëm dhe të volitshëm të punës për inspektorin,
 - b) Të siguroj dispozita kohore për ndonjë informatë të kërkuar administrative, financiare dhe teknike, dhe dokument të shkruar apo formë verbale pa nxjerr si shkak dispozitat e besueshmërisë,
 - c) T'i ofroj inspektorit qasje në pajisjet telekomunikuese në posedim apo administrim, ndërtesa, pjesët shtojcë, sistemet, aparatet, programe dhe pjesë elektronike,
 - d) Të ofroj infrastrukturën e nevojshme për inspektim dhe të mbaj infrastrukturën e tillë funksionale,
 - e) Të eliminoj defektet e përcaktuara në fund të inspektimit, brenda afateve kohore të përcaktuara nga Autoriteti.

Kompetencat e Inspektorit **Neni 6**

- (1) Kur i kërkohet të veproj asisoj, inspektori është i autorizuar (pajisur me kompetenca);
 - a) Të kërkojë, ekzaminojë dhe marrë kopjen origjinale dhe/ose kopjet e ndonjë lloj dokumenti dhe dosjeje duke përfshirë edhe të dhëna elektronike,
 - b) Të hyjë brenda dhe kryejë inspektime në pajisjet e administrimit, ndërtesave dhe pjesët e tyre shtojcë,
 - c) Të kërkojë informatë verbale dhe/ose me shkrim në lidhje me inspektimin dhe të hartoj raporte relevante,
 - d) Nëse e vlerësuar e nevojshme të kërkojë ndihmën e autoriteteve tjera kompetente për ofrimin dhe sigurimin e rendit dhe sigurisë publike.

- e) Të marrë parasysh pikëpamjet dhe mendimet e njësive tjera brenda Autoritetit, institucioneve publike dhe organizatave, si dhe personave fizik apo subjekteve ligjore në lidhje me inspektimin.

Obligimet e inspektorit Neni 7

(1) Inspektori është i obliguar;

- a) Para fillimit të inspektimit, të prezantoj veten e tij/saj tek pala e inspektuar përmes një letër autorizimi dhe/ose dokumentit të identifikimit që vërteton se ai/ajo është i/e autorizuar për të bërë një inspektim të tillë në emër të Autoritetit,
- b) Të mirëmbaj procesverbalet, librat, dokumentet dhe mostrat e pranuar, dhe nëse është nevojë të bëjë kthimin e tyre në fund të inspektimit,
- c) Të evitojë pengesat, shtesat apo amendamentimet në libra (procesverbale) të tillë, dokumentet dhe procesverbalet përveç atyre të shënuara dhe të kërkuara për qëllime të inspektimit,
- d) Të evitojë pikëpamjet dhe sjelljet në vendin e inspektimit, që mund të kenë efekt të dëmshëm në parimet e respektit dhe besimit të kërkuar për detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj,
- e) Të evitojë huazimin nga dhe/ose për palën e inspektuar dhe shmangien e përfitimit jo të drejtë pa marrë parasysh se çfarë është qëllimi,
- f) Të evitojë zbulimin e informatës konfidenciale dhe sekretet komerciale të marra gjatë inspektimit, përveç atyre ligjërisht të autorizuar, dhe gjithashtu të shmangë përdorimin e një informate të tillë dhe sekretet në mënyrë të tërthortë për përfitim personal apo për përfitim të palës së tretë,
- g) Të informoj me shkrim njësinë relevante menjëherë ,para përfundimit të inspektimit, nëse ai/ajo është duke inspektuar ndonjë çështje vendimi për të cilën mund të ketë ndikim të menjëhershëm negativ në treg..
- h) Të shmang ndërhyrjen me administrimin dhe aktivitetet ekzekutive të palës që i nënshtrohet inspektimit.

Obligimet e njësive relevante Neni 8

- (1) Njësia relevante është e obliguar të hartoj planet vjetore të inspektimit dhe të dërgoj propozimet në lidhje me aktivitetet e inspektimit sipas përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësisë të saj për vëmendje të njësisë koordinuese të inspektimit, propozon dhe caktoj inspektorët, bën bashkërendimin e nevojshëm, kujdeset për kompletimin e procedurave të miratuara për vendimet dhe raportet e inspektorit dhe të zbatoj masat dhe sanksionet e rëndësishme.

Njësia e bashkërendimit (koordinuese) të inspektimit
Neni 9

- (1) Njëra prej njësive kryesore funksionale të shërbimit të Autoritetit e caktuar si njësi e bashkërendimit të aktiviteteve të inspektimit që mbikëqyrret nga anëtari i caktuar i Bordit me qëllim të sigurimit të implementimit të planit dhe aktiviteteve të inspektimit dhe koordinimit të aktiviteteve të gjithëmbarshme të inspektimit të zhvilluara nga Autoriteti në funksion të ushtrimit të mandatit të mbikëqyrjes së tregut të telekomunikimeve.

KAPITULLI III
Procedurat dhe parimet e inspektimit

Procesi i inspektimit
Neni 10

- (1) Procesi i inspektimit përbëhet nga ekzaminimi, kontrolli paraprak dhe/ose fazat e hetimit.
- (2) Autoriteti mund të bëjë inspektimin me vet-iniciative (ex-officio) gjatë dhe në funksion të ushtrimit të rregullimit sipas parimeve Ex-ante dhe /apo pas pranimit të ndonjë informatë ose ankese të pranuar, nga organet apo palët e treta.
- (3) Njësia relevante mund të mos i procedojë ato informata apo ankese të cilat nuk kanë ndonjë adresë, emër apo nënshkrim.
- (4) Aktivitetet e inspektimit do të kryhen nga personeli i caktuar nga njësia relevante dhe kur është e nevojshme, personeli tjetër i autoritetit jashtë njësisë relevante mund të caktohet (emërohet) me miratimin e Kryetarit të Bordit.
- (5) Inspektori do të informoj, përgjatë secilës fazë të inspektimit njësinë relevante rreth çështjeve që nuk janë në përshkrimin e detyrave të tij/saj dhe se ajo mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin.
- (6) Korrespondencat e bëra nga inspektori do të bëhet përmes njësisë relevante.

Ekzaminimi
Neni 11

- (1) Inspektori do të bëjë ekzaminimin në dosje apo në vendngjarje në mënyrë që të përcaktoj nëse aktivitetet subjekt i inspektimit janë në pajtim me legjislacionin relevant dhe do të hartoj një raport analitik.
- (2) Në rast se aktivitetet e palës së inspektuar gjinden në fund të inspektimit dhe se ato janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit relevant dhe si të tilla ato nuk kërkojnë kontroll paraprak dhe/ose hetim, shefat e njësive relevante dhe/ose mbikëqyrësi i komisionit funksional do të dërgojnë në Bord dosjen e ekzaminimit bashkë me mendimet e tyre, nëse ka ndonjë.

- (3) Sidoqoftë, kushtet që kërkojnë zbatimin e sanksioneve administrative dhe masave pa vendim të Bordit janë të ndaluara dhe rezervuara për autoritetin ligjor si përcaktuar me legjislacionin relevant.
- (4) Pas ekzaminimit të dosjeve, Bordi do të jap vendimin e tij në pajtim me dispozitat e legjislacionit relevant.

Kontrolli paraprak Neni 12

- (1) Pas pranimit, të kërkesës nga njësia relevante, ankesës apo njoftimit Bordi mund të vendos automatikisht, që një kontroll paraprak të bëhet si dhe nëse është e nevojshme të fillohet hetim i drejtpërdrejtë apo hetim në lidhje me palën e inspektuar.
- (2) Nëse vendoset të procedohet me kontroll paraprak, Bordi do ti caktoj detyrë njësisë relevante që të bëjë kontrollin e kërkuar paraprak.
- (3) Inspektori i caktuar nga njësia relevante do të hartoj një raport paraprak mbi të gjeturat e hetimit, brenda tridhjetë (30) ditëve që nga data e emërimit të tij/saj. Kryesuesit e njësive relevante dhe mbikëqyrësi relevant i emëruar nga Bordi i Autoritetit do të dorëzojnë në Bord raportin paraprak të hetimit bashkë me mendimet e tyre, nëse ka ndonjë. Pas kërkesës së inspektorit, Bordi mund të japë vetëm njëherë, tridhjetë (30) ditë afat shtesë.
- (4) Kryetari i Bordit do ti jap përparësi raportit paraprak mbi hetimin në agjendë, dhe Bordi do të vendos brenda dhjetë (10) ditëve pas ditës së pranimit të raportit nëse një hetim duhet të fillojë apo jo.

Hetimi Neni 13

- (1) Në rast se Bordi vendos për fillimin e një hetimi, në mënyrë direkte apo në fund të raportit paraprak të hetimit, pastaj do të caktoj detyrë njësisë relevante për qëllime të hetimit. Inspektori i caktuar nga njësia relevante do të informoj palën e inspektuar rreth një vendimi të Bordit brenda një (1) jave pas emërimit të tij/saj. Inspektori do të përfundoj hetimin e tij/saj jo më vonë se dy (2) muaj pas emërimit të tij/saj.
- (2) Nëse në raportin e hetimit janë identifikuar kundërshtime me dispozitat e legjislacionit relevant, brenda një (1) jave një kopje e raportit do ti dërgohet palës së inspektuar si dhe duhet të jepen edhe dy (2) jave të tjera për të paraqitur mbrojtje me shkrim.
- (3) Secila mbrojtje e dërguar jashtë afatit kohor, do të shpërfillet. Në lidhje me paraqitje e mbrojtjes me shkrim nga ana e palës së inspektuar nën hetim për të cilin Autoriteti është i njoftuar përbrenda afatit relevant kohor, inspektori i emëruar do ti hartojë pikëpamjet e tij/saj dhe mendimet shtesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

- (4) Inspektori dhe/apo përmes mbikëqyrësit të njësisë koordinuese do të dërgojnë në Bord raportin e hetimit dhe dosjen e hetimit të përbërë nga mbrojtja me shkrim e palës në fjalë dhe pikëpamjet shtesë të inspektorit, bashkë me mendimet e tyre nëse ka ndonjë.
- (5) Kryetari i Bordit do ti japë përparësi dosjes së hetimit në agjendën e Bordit. Pas ekzaminimit të raportit të hetimit, Bordi do të japë vendimin e tij në pajtim me dispozitat e legjislacionit përkatës.

Njoftimi dhe shpallja e vendimit të Bordit Neni 14

- (1) Vendimit e Bordit duhet te nënshkruhen ne secilën faqe nga kryetari i Bordit dhe anëtarët e Bordit. Anëtarët që e kundërshtojnë vendimin do ti dërgojnë pikëpamjet e tyre kundërshtuese dhe arsyet përkatëse jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e vendimit dhe te njëjtit duhet të nënshkruajnë raportin relevant. Një kopje e miratuar e vendimit do ti bëhet me dije (njoftohet) palës së inspektuar nën hetim.
- (2) Nëse është e nevojshme Bordi do të njoftoj opinionin publik me vendimet e tij, të cilat do të publikohen në ueb faqen e Autoritetit www.art-ks.org duke u përkujdesur qe te mbahen dhe mos zbulohen sekretet afariste të palës në fjalë.

KAPITULLI IV Shumëanëshmëria dhe dispozitat përfundimtare

Zbatimi i masave dhe sanksioneve administrative Neni 15

- (1) Në rast se pala e inspektuar nuk i plotëson obligimet e saja sipas kësaj rregulloreje, apo aktivitetet e palës së inspektuar janë gjetur në fund të inspektimit të jenë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit relevant, atëherë masat dhe sanksionet e përcaktuara nga dispozitat e legjislacionit relevant do të zbatohen nga njësitë relevante pas nxjerrjes së vendimeve nga autoriteti ligjor, Bordi i ART-së.

Parashtrimi i kërkesës tek organet gjyqësore dhe administrative Neni 16

- (1) Në rast se informata apo dokumenti i marrë gjatë ndonjë faze të inspektimit përcaktohen se janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit relevant, një vendim mund të dërgohet tek ndonjë autoritet juridik apo administrativ përfshirë edhe gjykatën (në procedure të rregullt gjyqësore). Vendime të tilla do ti behën të ditura autoriteteve relevante menjëherë.

**Udhëzim
Neni 17**

- (1) Një Udhëzim do të lëshohet nga Autoriteti në mënyrë që të identifikohet procedura dhe parimet që drejtojnë njësitë relevante sikurse edhe inspektorin, për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin e planeve të inspektimit sikurse edhe procedurat e punës dhe parimet e Njesisë për koordinimin e aktiviteteve të Inspektimit.

**Hyrja në fuqi
Neni 18**

- (1) Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordi i ART-së dhe do të mbetet në fuqi deri në miratimin e një rregulloreje të re nga Bordi i ART-së.

**Zbatimi
Neni 19**

- (1) Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit përkujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

**Klasa: 01 / 11
Nr. i Reg. 12**

Prishtinë, 21/ 11/ 2011

**Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit të ART-së**
